



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:017742

Datë: 05.11.2024

Numri i dokumentit: 06404996

PPP.nr.179/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, në përbërje me gjyqtarin Fuad Haliti dhe me bashkëpunëtorin profesional Eron Prekazi, në çështjen juridike të kreditorit F.H nga Mitrovica, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit av.Amir Bunjaku, kundër debitorit Komuna e Mitrovicës Jugore, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit av.Lirim Zeka, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, jashtë seancës gjyqësore me datë 05.11.2024 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I. **REFUZOHET** si i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e Mitrovicës Jugore, i ushtruar kundër urdhërit përmbarues P.nr.... i datës ... mbi lejimin e përmbarimit të propozimit për përmbarim të datës ..., të kreditorit F.H nga Mitrovica.

II. **LIHET** në fuqi urdhërit përmbarimor mbi lejimin e përmbarimit P.nr.... i datës

Arsyetim

Kreditori, F.H nga Mitrovica me datën ..., ka paraqitur propozimin për përmbarim sipas titullit përmbarimor – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë C.nr.... i datës ..., kundër debitorit Komuna e Mitrovicës Jugore.

Përmbaruesi Privat, me urdhërin përmbarimor P.nr.... i datës ..., ka lejuar propozimin për përmbarim të kreditorit F.H nga Mitrovica.

Kundër këtij urdhëri, debitori në afat ligjor ka paraqitur prapësimin duke i propozuar gjykatës që ta rafuzojë propozimin për përmbarim dhe ta anulojë pjesërisht urdhërin përmbarimor dhe atë sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore.

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore, parashihet “*Dokumente përmbaruese janë: vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese.*”

Në bazë të nenit 23 paragrafi 2 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore, parashihet që “*Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në*

procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdj gjyqësore konsiderohet ujdja e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetimit.”

Në bazë të nenit 24 paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore, parashihet që “*Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbartueshem po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”*

Në bazë të nenit 27 paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore parashihet që “*Dokumenti përmbartimor është i përshatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”.*

Gjykata, vlerëson se dokumenti përmbartimor - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë C.nr.... i datës ..., sipas dispozitave të lartëcekura është i përshatshëm për përmbartim dhe për këtë arsye edhe refuzojë prapësimin e debitorit.

Gjykata, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore, duke iu referuar dispozitave ligjore të nenit 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se “*Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore*”, përjashtimisht Gjykata mund të caktoj seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimin.

Andaj nga sa u tha më lartë, në bazë të nenit 73 të LPP-së, dhe në bazë të argumentimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
PPP.nr.179/24, me datë 05.11.2024

Gjyqtari
Fuad Haliti

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankese, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.